



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.108 /2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazic kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër një pjesëtari të Policisë së Kosovës, për shkak të qëndrimit të tij brenda Qendrës të Votimit (QV), për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Glllogocit, në seancën e panelit të mbajtur me 07.12.2016, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet poshtë si e palejuar ankesa Anr.108/2016 e datës 05.12.2016 e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.12.2016, nga BIRN dhe Internews Kosova, me të cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit 0318E, në shkollën fillore “Shaban Polluzha”, në fshatin Polluzhë të Komunës së Glllogocit, gjatë kohës së votimit njëri nga policët kishte qëndruar brenda objektit në korridor të shkollës, afër vendvotimeve.

Sipas parashtresit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 84 par. 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) në Republikën e Kosovës.

Parashtresit i ankesës në cilësi të provës, ankesës ia ka bashkangjitur një CD me inqizimin e rastit si dhe një kopje nga web faqja e portalit “www.kallxo.com” që ka të bëjë lidhje me rastin në fjalë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës gjeti se **ankesa është e palejuar**, për këto arsye:

Pretendimet e parashtresit të ankesës se pjesëtari i Policisë së Kosovës, ka qëndruar para Vendvotimit të lartpërmendur, paneli i PZAP-it, nuk është lëshuar në shqyrtimin e kësaj çështje sepse kjo çështje nuk është nën juridiksionin e PZAP-it, të vendosë se ku qëndrojnë Policia e Kosovës në ditën e votimit. Dispozita ligjore e nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së,

përcakton se PZAP-i, është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e theksuara me lart dhe në dispozitën lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në Prishtinë

Anr.108/2016 më datën 07.12.2016



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë konform nenit 118.4 të LZP-së.